



KREU LAJMI FUNDIT THELLË POLITIKË KRONIKË EKONOMI JETË KULTURË SHËNDETI KOSOVË BOTË SOFT SPORT

**x2** përfitime  
 1000 Minuta ndër/kombëtare  
 2 GB  
 1000 Lekë

KULTURË

# Arti që të çon drejt lirisë së munguar

Valeria Dedaj | 27 Maj 2015, 10:15 | Përditësuar 10:38



## TEMAT KRYESORE

Valeria Dedaj

Artisti Agim Sulaj vlerësohet me çmimin e madh në Bienalen e katërt. Ndërkombëtare të humorit dhe satirës, me veprën me titull "Liria". Vepra fituese pasqyron një dorë me një laps, e rrethuar me telat e burgimit, që gjen mundësinë për të qenë e lirë

Nëse do të numëronim të gjitha çmimet ndërkombëtare që Agim Sulaj ka fituar përgjatë karrierës së tij artistike në mbarë botën, do të na duhej kohë, sepse numri i tyre shkon në rreth, 70-të tilla. Ditët e fundit ai u vlerësua me çmimin e madh në Bienalen e 4-të Ndërkombëtare të Humorit dhe të Satirës me punën e titulluar "Liria". Vepra e tij do të qëndrojë në Pallatin Mbretëror të Republikës Portugeze nga data 20 maj deri në 20 qershor. Gjatë një bisede për "Shekulli"-n ai shpjegon konceptin e tij mbi lirinë edhe se pse zgjedh përherë që veprave të tij të mos u vendosë diçitura apo paragrafë.

Vepra fituese pasqyron një dorë me një laps, e cila, dhe pse e rrethuar me telat e burgimit, gjen mundësinë për të qenë e lirë. "Është kënaqësi të shoh vizatimin tim të vlerësuar në një mjedis të tillë, madhështor, ku liria është i vetmi simbol i njeriut". Sipas Sulajt, liria është e lirë si ajri dhe nuk mund të burgoset. Këtë vlerësim ai e bën jo vetëm për krijimtarinë e tij, por edhe për dëshirën që përfaqëson në mënyrë simbolike liria që ndodhet te të gjithë ne.

E teksa na tregon se liria është dëshira më e plotë dhe më ngacmuesja që e bën njeriun të ndiejë dhe të vlerësojë në thelb vlerën e jetës, tërë modesti, vazhdon duke thënë: "Ky çmim është vlerësimi më i mprehtë, që mund t'u bëhet veprave, të cilat vizatojnë lirinë". E kur e pyesim nëse i ka ndodhur ndonjëherë gjatë fëmijërisë apo jetës së tij, që t'i kenë privuar lirinë, ai thotë: "Kur liria është e penguar, njeriu kërkon me çdo mjet të shprehet dhe për këtë gjen shtigje të 'parrahura' nga të tjerët. Rasti i veprës në fjalë ka lindur si një gjetje e imja ku, pikërisht, mungesa fizike e lirisë e bën artistin apo, thjesht, njeriun të arratiset në mënyrë imagjinare".

Sipas piktorit, mënyra e të shprehurit nëpërmjet artit mbetet forma më e plotë në shoqërinë tonë, ku,

11 0 0  
 Share Tweet Google +

Like 189,712 people like this. Sign Up to see what your friends like

## Lajmet më tërheqës

Pesë lajmet më të populluara për sot

- | Lexuara   | Komentuara |
|---|------------|
| Ja kush është femra që u ngatërrua me Grida Dumën (FOTO)            | 1          |
| Italiani, vrasës me pagesë, në Tiranë erdhi për ekzekutimin e Lufit | 2          |
| Rihanna bashkëpunim me një shqiptar nga Kosova (VIDEO)              | 3          |
| Serbia e gatshme të 'shkëputet' nga Rusia                           | 4          |
| Al Qaeda urdhëron të mos sulmohet Perëndimi                         | 5          |

ALBtv, çdo gjë rreth teje!  
 ALBtelecom eagle

From The Web

Sponsored Links by Taboola

Sprint  
 The C  
 Your  
 Half I  
 Get half of  
 Verizon or  
 plan.  
 Switch  
 Restrictions apply

sado e zhvilluar të jetë liria, përsëri njeriu ndihet rob i dëgjave apo skllav i mendësive e ligjeve të shoqërisë. Agim Sulajt nuk i pëlqen që të shpjegojë gjatë veprat e tij, sepse mendon se ato flasin vetë. Fakt ky që duket te mungesa e diçturave dhe paragrafëve ndihmës, gjithsesi, ai tregon: "Telat përfaqësojnë një lloj burgimi imagjinar të njeriut dhe po ashtu një arratisje imagjinare drejt lirisë, nuk i dedikohen një rast konkret".

Krijimtaria e Sulajt mbështetet në dy drejtime. Piktura i referohet mbresave e ngacmimeve të fëmijërisë, peizazheve e rugicave të pikturuara me një teknikë hiperrealiste. Ndërsa në karikaturë mesazhi është më social, herë-herë më i mprehtë e herë-herë më i revoltuar karshi dukurive të jetës apo dëmtimeve të natyrës. Ky stil e veçon punën e tij nga autorët e sotëm. Megjithatë, me karikaturën i ka prirë më tepër e mbara, një gjini që ai e ka lëvruar qysh në vitet tetëdhjetë të "Hosteni", revista kryesore e humorit dhe satirës në Shqipërinë Socialiste, e ndoshta media më e lirë ndër mediat e mbikëqyruara rreptë nga censura në çdo cep. Me mjaft sukses ai ka përfaqësuar veten në nivelet botërore të karikaturës dhe këtë e tregon vlerësimi me çmimet ndërkombëtare në World Press Cartoon, Ranan Lurie Award, Eç Krushoutem, Iran Cartoon etj...



**Agim Sulaj** (Tiranë, 1960) u vendos në Vlorë në moshën 2-vjeçare. Ndoqi liceun dhe studimet për pikturë i përfundoi në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë. Italia është vendi ku jeton si artist i lirë dhe ka ekspozuar në qytetet e Brindizit, Venecias, Bolonjës, Milanos, Romës etj. Punët e tij kanë qarkulluar në ekspozita kolektive në mjaft vende të Evropës, përfshi edhe Shqipërinë. Temat e emigracionit me eksplorimin e botës shqiptare në vend të huaj ai i ka trajtuar në ekspozitat "Midis vëllezërve të Italisë", "Artisti me valixhe" apo tjetër, lidhjet që njeriu ruan nëpërmjet kujtimeve me botën e shkuar në ekspozitën "Vepra Hiperreale" etj.

**Valeria Dedaj**

Shtoni një koment

1 Komente

arben

Vai Gimo..suksese


Ju Rekomandojmë



**Sali Shijaku, piktori i cili ka ditur të gdhendë**



**Arti që të çon drejt lirisë së munguar**



**Inva Mula: Pasioni nuk mjafton për të krijuar**



**Duke kërcyer, realizova ëndrrën time**

Gazeta 'Shekulli' iu kërkon gjithë lexuesve të saj, që mundësisht të mos përdorin sharje, fyerje denigruese ndaj dinjitetit njerëzor nëpër komente. Në vend të tyre, faktet dhe argumentet tuaja lojike mund të jenë shumë më të fuqishme pa to. Me respekt dhe falemnderit për pjesëmarrjen tuaj, mjaft të vlefshme në punën tonë!

Ftojme lexuesit, që nëse kanë opinione mbi shkrimet e botuara te 'Shekulli' apo mbi tema të tjera të lira, mund të na kontaktojnë në adresën: [komente@shekulli.com.al](mailto:komente@shekulli.com.al)

Shtoni një koment



**How This Razor is Disrupting a \$13 Billion Industry**  
Dollar Shave Club



**Dr. Ron Paul's Big Warning For U.S. Seniors**  
Stansberry & Associates



**Should Auctions be Banned? Brand New iPads Have Sold for...**  
QuiBids



**14 Benefits Most Seniors Didn't Know They Had**  
Newsmax

Videot e fundit »



**Trajneri i Sevilla-s këndon për të festuar triumfin në Europa League**



**SHBA në prodhim e sipër të bombës elektromagnetike (EMP)**



**Ishte hutuar nga biseda në celular, e pickon gjarpri**



**Hajdut i pashpirt, nuk kursehet as tek makina e të paralizuarit**



**"Mbreti i xhunglës" i paaftë për të shpëtuar veten**

**Abissnet**  
#SuperOferteVerore

- 3+1** Paguesh 3 muaj shërbim internet, mëmë 1 muaj **PAKAS**
- 6+2** Paguesh 6 muaj shërbim internet, mëmë 2 muaj **PAKAS**
- 12+4** Paguesh 12 muaj shërbim internet, mëmë 4 muaj **PAKAS**

Për një verë që zgjat më shumë me Abissnet...

**Shekulli Soft»**

Lajme interesante nga Bota e ShowBiz



**Ja kush është femra që u ngatërrua me Grida Dumën (FOTO)**

Emri (jo i domosdoshem)

3 + 5 =  Captcha (e domosdoshme)



**Rihanna bashkëpunim me një shqiptar nga Kosova (VIDEO)**



**Ben Affleck dhe Jennifer Garner drejt divorcit**



**Po Shqipëria, nuk ishte një vend i botës së tretë?**



**Rekord botëror, mbi 1 mln bletë në trup (VIDEO)**